

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-33/21-06

Prishtinë, më 9 e 10 tetor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën në fillim e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 1 e 6, 14 dhe 21 shtatorit 2006,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/17 Për prokurimin publik në Kosovë”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nrë 2004/49 ”Për patentim”,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hulumtimet gjeologjike,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin riprodhues,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për peshkatari dhe aqualkulturë,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/05 ”Për naftë dhe derivatet e saj”.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se të gjitha materialet e nevojshme për këtë seancë u janë shpërndarë me kohë deputetëve të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare nuk ka arritur asnjë propozim me shkrim për ta plotësuar rendin e ditës, të propozuar nga Kryesia e Kuvendit. Ai kërkoi që të procedohet sipas rendit të propozuar.

1. Miratimi i rendit të ditës

Deputeti **Xhevat Bislimi** kërkoi që në rend dite të kësaj seance të radhitet edhe kërkesa e partive politike dhe e shoqatave të Vitisë dhe të Gjilanit për organizimin e Referendumit për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Deputeti **Ramdan Kelmendi** kërkoi që Kuvendi t'i shqyrtojë edhe kërkesat e qytetarëve të pjesës veriore të Mitrovicës, si dhe Grupi Negociator ta vizitojë atë pjesë.

Kryetari tha se kërkesat duhet të parashtrihen në përputhje me procedurat e Kuvendit.

Pasi që nuk ka arritur asnjë propozim me shkrim nga grupet parlamentare për ta amendamentuar rendin e ditës, atëherë procedohet me rendin e ditës, të propozuar nga Kryesia e Kuvendit.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 1 e 6, 14 dhe 21 shtator 2006

Procesverbalet e seancave plenare të 1 e 6, 14 dhe 21 shtatorit 2006 u miratuan pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeteti **Emrush Xhemajli** pyeti ministrin e Drejtësisë se çka ndërmarr kjo ministri për lirimin e ish ushtarit të UÇK-së, z.Anton Lekaj , që ishte dënuar në Beograd me 13 vjet burgim.

Ministri **Januz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Gazmend Muhaxheri** pyeti ministrin e Mjedisit dhe të planifikimit Hapësinor lidhur me formimin e Këshillit për Planifikim Hapësinor.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhaxheri.

Deputeti **Hydajet Hyseni** pyeti Qeverinë e Kosovës lidhur me mënyrën e shpenzimeve të mjeteve për sanimin e pasojave të tërmetit në komunën e Gjilanit.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk ishte i pranishëm. Përgjigjja pritet për seancën e radhës.

Deputeti **Ramdan Kelmendi** përsëriti pyetjen për ministrin për Kthim dhe Komunitet lidhur me kthimin e 23 mijë shqiptarëve që ishin larguar nga pjesa veriore e Mitrovicës.

Ministri **Sllavisht Petković** nuk ishte i pranishëm. Pyetja duhet të botohet në Buletin e Kuvendit.

4. **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/17 Për prokurimin publik në Kosovë**

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri, **Agim Çeku**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurorimin publik, si dhe për pengesat që ishin paraqitur gjatë zbatimit të tij..

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga kryeministri Çeku, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Mazllun Kumnova, Nazim Jashari, Mahir Yagcillar, Numan Baliq, Ramadan Kelmendi, Sevdije Halimi dhe Behxhet Brajshori**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 52;

Kundër-----16.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e **miratoi në parim** Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/17 “Për prokurimin publik në Kosovë”.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa - Komision Përgjegjës - Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

5. **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/49 ”Për patentim”**

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, si dhe për pengesat që kishte hasur gjatë zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Dugolli, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Januzi, Hatixhe Hoxha, Xhevdet Neziraj, Nazim Jashari, Mahir Yagcilar dhe Numan Baliq**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 59;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/49 "Për patentim".

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, **Sadik Idriz**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministri Idrizi shpjegoi qëllimin, strukturën dhe mënyrën e zbatimit të Projektligjit për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Idrizi kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naim Jerliu, Zahrije Isufi, Zylfije Hundozi, Fatmire Mulhaxha, Xhezait Murati, Ferid Agani dhe Ilaz Pireva**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 65;

Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale - Komision Përgjegjës - Raportues – që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Kryetari dha pauzë për drekë.

Pas pauzës seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga zhurma

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ardian Gjini, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushime ligj të ri.

Në vazhdim ministri Ardian Gjini shpjegoi qëllimin, strukturën dhe mënyrën e zbatimit të Projektligjit për mbrojtje nga zhurma.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Gjini, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nekibe Kelmendi, Afrim Arzuallxhiu, Mazllun Kumnova, Gazmend Muhaxheri, Rifat Krasniq, Gjergj Dedaj, Remzije Nimani, Emrush Xhemajli, Husnija Beshkoviq, Berat Luzha, Naxhije Doçi dhe Selvije Halimi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 61;

Kundër----- 1.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor- Komision Përgjegjës - Raportues – që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Agron Dida**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim zëvendësministri **Dida** shpjegoi qëllimin, strukturën, mënyrën e zbatimit, si dhe implikimet buxhetore të Projektligjit për pajisjet nën presion.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri, Agron Dida, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, Hatixhe Hoxha, Mazllun Kumnova, Genc Gorani, Xhezair Murati, Gjergj Dedaj dhe Qibrije Hoxha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 4;

Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për pajisjet nën presion.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - Raportues – që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për Projektligjin për trashëgiminë kulturore.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 (reformular), 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 (reformular), 17, 18, 19, 20, 21(reformular), 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39 a (i plotësuar), 40, 41 (reformular), 42, 43, 44, 45, 46 (b), 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58 dhe 59.

Kryesuesi Projektligjin dhe amendamentet në tërësi i hodhi në votim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----56;

Kundër-----14.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për trashëgiminë kulturore.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 16:20 minuta.

E martë, 11 tetor 2006

Vazhdim i seancës, ora 10:00

Të pranishëm ishin 79 deputetë.

Seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, i ndihmoi **Xhavit Haliti**.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hulumtimet gjeologjike

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion – Komision Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit Raportues.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Kryesuesi Projektligjin dhe amendamentet në tërësi i hodhi në votim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----53;

Kundër-----19.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për hulumtimet gjeologjike.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin riprodhues

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale – Komision Raportues - në Ligjin për shëndetin riprodhues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit Raportues.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 dhe 26.

Kryesuesi Projektligjin dhe amendamentet në tërësi i hodhi në votim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----67;

Kundër-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për shëndetin riprodhues.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për peshkatari dhe aqualulturë

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Komision Raportues - në Ligjin për peshkatari dhe aqualulturë.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit Raportues.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Kryesuesi Projektligjin dhe amendamentet në tërësi i hodhi në votim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----72;
Kundër-----8.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për peshkatari dhe aqualulturë.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/05 "Për naftë dhe derivatet e saj"

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion – Komision Raportues - në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/05 "Për naftë dhe derivatet e saj".

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit Raportues.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Kryesuesi Projektligjin dhe amendamentet në tërësi i hodhi në votim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----65;
Kundër-----2.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/05 "Për naftë dhe derivatet e saj".

Shënim: Pjesë përbërëse e këtij procesverbali është transkripti i kësaj seance.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 11:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Sektori për Çështje Plenare dhe Procedurale